

HIDROFOB KRISTAL

Aditiv për betone dhe llaçe me veprim të dyfishtë, prodhim të betonit me veti hidrofobe, i cili në kontakt me ujin dhe lagështinë e shtuar formon kristale në çarjet dhe poret e betonit për të parandaluar depërtimin e mëtejshëm të ujit dhe zhvendosjen e tij. Inhibitor(pengues) i korrozionit të armaturës
Në përputhje me: EN 934-2: T9

FUSHA E APLIKIMIT

Si aditiv(shtesë) për beton, parandalon depërtimin kapilar të ujit nëpër beton. Në kontakt me ujin, ai formon struktura kristalore dhe kështu mbyll poret dhe çarjet në vetë betonin. Gjithashtu vepron në sipërfaqe duke rritur hidrofobicitetin e masës së betonit ose llaçit(suvasë). Kjo parandalon depërtimin e ujit dhe agresioneve (si p.sh. kripërat, kloruret dhe sulfatet) në beton. Rekomandohet për përgatitjen e betonit në ndërtesa që janë në kontakt me ujin, si p.sh.: pjesë të groposura ndërtesash, themele, mure mbajtëse, porte, rezervuarë, pishina, kulla ftohëse, ura, shahte, tunele etj.

CILËSITË

- Rrit rezistencën e betonit dhe llaçit ndaj depërtimit të ujit nën presion;
- Redukton thithjen kapilar të ujit nëpër seksionet e betonit duke mbyllur kapilarët dhe mikroçarjet me formimin e kristaleve;
- Duke parandaluar depërtimin e ujit përmes betonit, redukton karbonizimin dhe rrit qëndrueshmërinë e betonit në kushte të ekspozimit ndaj akullit, kripërave dhe përqendrimit të lartë të CO₂;
- Pengues i korrozionit dhe mbrojtje shtesë e armaturës.
- Rritja e fortësisë përfundimtare të betonit me të paktën 5%.
- Mundëson mbylljen e çarjeve në strukturën e betonit me gjerësi deri në 0.5 mm.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE, PAMJA DHE FORMA

CILËSIA	METODA	VLERA E DEKLARUAR
Pamja	Vizuele	Krem-substancë në pluhur
Dendësia nën presion		0,65 kg/dm ³

Hidrofob Kristal dozohet gjatë përgatitjes së betonit në përzierjen e betonit të freskët pasi të jenë dozuar aditivët e tjerë.

Doza e rekomanduar është 3-4 kg/m³ beton.

Në rastet kur dozimi është mbi bazën e betonit, Hidrofob Kristal dozohet së bashku me agregatin dhe përziehet për të paktën 30 sekonda përpara se të shtohet uji dhe çimentoja e nevojshme. Më pas, nevojitet përzierje shtesë prej 45 sekondash, derisa përzierja e betonit të jetë gati për përdorim.

Në rastet kur dozimi bëhet direkt në mikserin për transportimin e betonit, rekomandohet që aditiv të dozohet në mikser në një sasi betoni që është më së shumti 70% e kapacitetit të përgjithshëm. Përpara se të dozoni Hidrofob Kristal në mikser, rekomandohet përgatitja e tij duke shtuar ujë në raport 2:1 (Uji : Hidrofob Kristal), derisa të arrihet një masë e lëngshme. Gjatë shtimit të masës së lëngshme të Hidrofob Kristalit, përzierja me mikser duhet të jetë intensive dhe konstante. Pas shtimit të sasisë së paraparë, përzierja intensive e mikserit duhet të vazhdojë të paktën 1 min/m³, por jo më pak se 5 minuta. Përzierja e vazhdueshme është e nevojshme për shpërndarjen e saktë të aditivit në të gjithë masën e betonit në mënyrë që të arrihet efekti i duhur prej tij.

Për të arritur performancë të lartë të padepërtueshmërisë së ujit në sipërfaqet e betonit, rekomandohet që Hidrofob Kristali të aplikohet në beton me të paktën C25/30 klasë(shkallë) të fortësisë(ngurtësisë) së presionit.

Fq. 1 nga 3

Në të njëjtën kohë, është e një rëndësie të veçantë që procesi i plotë i përgatitjes, transportit, montimit dhe përkujdesjes së betonit të jetë në përputhje me kushtet e ndërtësës.

Formimi i kristaleve në vetë betonin fillon me aktivizimin e substancave në Kristal Hidrofobin me kontaktin ose depërtimin e ujit në beton. Varësisht nga lloji i betonit, dozës, llojit të çimentos së përdorur, si dhe të shkallës së ekspozimit të betonit në kontakt me ujin, formimi i kristaleve zakonisht fillon jo më herët se 1 javë pas kontaktit të parë me ujin dhe mund të zgjasin për një periudhë më të gjatë kohore. Nëse vetë betoni nuk është i ekspozuar ndaj ujit për një kohë të gjatë, kristalet nuk formohen në strukturën e betonit.

KOMPATIBILITETI

Për të arritur një shkallë të lartë hidroizolimi, rekomandohet përdorimi i Hidrofob Kristalit në kombinim me një nga aditivët nga grupi i plastifikuesve ose superplastifikuesve të programit ADING. Hidrofob Kristal përdoret në kombinim me aditivë nga grupi Fluiding, Superfluid dhe Superfluid 21. Aditivët e ndryshëm në beton dozohen veçmas, pra nuk përzihen me njëri-tjetrin përpara se të shtohen në përzierjen e betonit.

Kur përdorni lloje të caktuara të çimentos, ngjitja e betonit mund të ngadalësohet dhe fortësia (ngurtësia) mund të reduktohet në fazën e hershme (deri në 1 ditë).

Hidrofob Kristal mund të përdoret në kombinim me aditivë për betonimin dimëror nga programi Adding.

Rekomandohet kombinimi i tij me Hidrozim Fluid.

Kur përdoren dy ose më shumë aditivë në beton, është e nevojshme të kryhen teste paraprake laboratorike për të përcaktuar dozën e saktë për të fituar performancën e kërkuar të betonit.

PAKETIMI

Në thasë prej 4 dhe 20kg

RUAJTJA NË DEPO

Në paketimin origjinal, në një temperaturë prej 5°C deri në 35°C dhe të mbrojtur nga ekspozimi direkt i rrezeve të diellit. Afati i ruajtjes 12 muaj.

SHENJA E CERTIFIKIMIT TË PRODHIMIT

 2032	
ADING AD Shkup Novoselski pat (rruga 1409) nr. 11, 1060 Shkup, Maqedoni e Veriut 20	
GAEF001/2	
EN 934-2:2009+A1:2012	
HIDROFOB KRISTAL	
Përmbajtja e joneve të klorit	≤ 0,1% sipas masës
Përmbajtja e alkaleve	≤ 2,0% sipas masës
Veprimi korroziv	Përmban komponentë vetëm të EN 934-1:2008-shit, Aneks A.1

Fq. 2 nga 3

Rreziku për shëndetin: Hidrofob Kristali nuk përmban materie toksike. Duhet pasur kujdes që materiali të mos bie në kontakt me lëkurën, sytë ose të gëlltitet. Në rast kontakti me lëkurën ose sytë, është e nevojshme të shpëlahen menjëherë me ujë të pastër të rrjedhshëm. Nëse gëlltitet, kërkoni kujdes mjekësor. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së Produktit.

Zjarri: Hidrofob Kristali është një material pluhur jo i ndezshëm. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së Produktit.

Pastrimi dhe asgjësimi: Paketimi i vjetër i përdorur duhet të hidhet sipas rregulloreve lokale për atë lloj mbetjesh. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së Produktit.